



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/MINISTRY OF  
CULTURE, YOUTH AND SPORTS  
AGJENCIA SHETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS/DRZAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA/ STATE AGENCY OF  
KOSOVO ARCHIVES

---

## ***AGJENCIA SHETËRORE E ARKIVAVE E KOSOVËS***



### ***RAPORT VJETOR I PUNËS***

***2020***

**Prishtinë, 2021**

**Përmbajtja**

|   |    |
|---|----|
| 1. Fjala e Kryeshefit.....  | 3  |
| 2. Përmbledhje Ekzekutive.....  | 4  |
| 2.1 Mandati dhe përgjegjësit.....   | 4  |
| 2.2 Struktura Organizative.....   | 4  |
| 3. Avancimi i Kornizës Ligjore.....   | 5  |
| 4. Investimet Kapitale.....   | 5  |
| 5. Rregullimi, përpunimi, mbrojtja dhe digjitalizimi i lëndës arkivore..... | 6  |
| 5.1 Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore.....                         | 6  |
| 5.2 Mbrojtja e lëndës arkivore.....   | 7  |
| 5.3 Digjitalizimi i lëndës arkivore.....                                    | 7  |
| 6. Shërbimi i qytetarëve me dokumente arkivore.....                         | 8  |
| 7. Biblioteka e Arkivit.....  | 9  |
| 8. Pranimi i lëndës arkivore dhe inspektimi te fondkrijuesit.....           | 9  |
| 9. Zhvillimi i politikave në AShAK.....                                     | 9  |
| 10. Bashkëpunimi Ndërkombëtar Arkivor.....                                  | 10 |
| 11. Publikimi i dokumenteve arkivore.....                                   | 11 |
| 12. Buxheti dhe Financat.....   | 11 |
| 13. Prokurimi.....  | 13 |
| 14. Burimet Njerëzore.....  | 14 |

## 1. FJALA E KRYESHEFIT

### Vit i vështirë

Viti 2020 ishte viti i parë që unë kam filluar punën në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK). Për kohëzgjatje, po ky vit, pothuaj me fillimin e punës sime në këtë detyrë, erdhi me një të papritur e cila njerëzimin në përgjithësi, dhe shtetin e Kosovës në veçanti i gjeti të papërgatitur.

Në këtë kontekst, edhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës u gjend para një sfide të re kur në dhjetëditëshin e dytë të marsit të vitit 2020 u identifikuan rastet e para të infektuara me COVID-19, një virus i panjohur deri në këtë kohë, që brenda një periudhe të shkurtër mori përmasat e pandemisë globale.

Ishte kjo një sfidë e re, me shumë të panjohura, që na shoqëroi gjatë gjithë vitit dhe po vazhdon ende.

Megjithatë, falë përkushtimit të punonjësve të AShAK-së, puna nuk u paralizua dhe procesi i saj vazhdoi, sado me kapacitete të kufizuara.

Kjo është dhe arsyeja që ne si institucion nuk ia kemi dal të realizojmë qind për qind Planin e punës që e kishim të miratuar në krye të vitit.

E rëndësishme është që ne nuk u bllokua plotësisht dhe shmangëm rrezikun duke gjetur forma adekuate të organizimit të punës, duke iu përmbajtur besnikërisht vendimeve të Qeverisë dhe udhëzimeve të IKSHPK për parandalimin e përhapjes së këtij virusi, e që qonin në reduktim e aftësisë operative por jo dhe në paralizimin e saj.

Njëjtë do të vazhdojmë dhe në vitin 2021.

**Bedri Zyberaj**  
**Kryeshef Ekzekutiv**

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 2.1 Mandati dhe përgjegjësit

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës (tutje Agjencia), si institucioni më i lartë përgjegjës për pasurinë arkivore në Republikën e Kosovës, vizion të saj ka progresin në përmirësimin e kushteve për ruajtjen e lëndës arkivore në vend, duke evidentuar, pranuar, rregulluar, përpunuar, klasifikuar, restauruar, konservuar dhe digjitalizuar lëndën arkivore, si dhe duke dhënë për shfrytëzim atë për qëllime profesionale, shkencore, publicistike dhe për nevojat tjera të qytetarëve apo institucioneve të Republikës së Kosovës dhe përtej saj.

Agjencia ushtron funksionin e saj në bazë të Ligjit nr. 04L/088 për Arkivat Shtetërore dhe në Standardet Ndërkombëtare të Arkivistikës.

Agjencia administron dokumentet arkivore të nivelit qendror, lokal dhe te të gjithë fondkrijuesit e Republikës së Kosovës, përveç kur është e rregulluar ndryshe me legjislacionin në fuqi.

Raporti i punës për vitin 2020, pasqyron të arriturat e Planit të punës 2020, edhe përkundër paraqitjes së shumë faktorëve kufizues me të cilët u ballafaquam gjatë vitit, siç janë: kushtet jo adekuate infrastrukturore, mungesa e pajisjeve teknologjike, mungesa e burimeve njerëzore, trajnimet profesionale, e sidomos gjendja pandemike me COVID – 19 e krijuar në vend.

Agjencia, gjatë vitit 2020, ka punuar sipas Vendimeve të nxjerra nga Kryeshefi Ekzekutiv, duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë së Kosovës dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, për mbrojtje nga COVID – 19.

### 2.2 Struktura Organizative

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e saj.

Struktura Organizative e Agjencisë, përbëhet nga katër (4) Departamente – Departamenti për Veprimtari Arkivore; Departamenti për Arkiva Ndërkomunale dhe Inspektim; Departamenti për Politika Zhvillimore dhe Departamenti për Administratë dhe Financa; tetë (8) divizione dhe shtatë (7) Arkiva Ndërkomunale (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj).

Arkivi Ndërkomunal i Ferizajt është themeluar në vitin 2019, me Vendim të MKRS, ndërsa në vitin 2020 nga Kuvendi Komunal i Ferizajt është ndarë një objekt për të funksionalizuar atë. Objekti i ANK-Ferizaj është duke u rinovuar, për të mundësuar funksionalizimin dhe plotësimin e kushteve për punë.

Numri i aprovuar i të punësuarve në Agjenci në vitin 2020 ishte 105.

### 3. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Pas aprovimit të Koncept Dokumentit për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv, mori Vendim për formimin e Grupit punues për hartimin e Draft Ligjit për Arkivat. Grupi punues i përbërë nga 10 anëtarë, i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv filluan punën për hartimin e Draft – ligjit nga data 29.6.2020 deri me 4.7.2020 në Gjilan. Pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit publik të brendshëm e të jashtëm, Draft – ligji për Arkiva është dorëzuar në MKRS për t’u proceduar në Qeveri për miratim.

### 4. INVESTIMET KAPITALE

Agjencia ka qenë përfutuese e Projektit për Efijencë të Energjisë në Kosovë, ku gjatë vitit 2020 kanë filluar punimet për izolimin e Ndërtesës së Arkivit në Prishtinë, ndërrimin e dritareve, riparimi i radiatorëve, ndërrimi i ventileve në sistemin e ngrohjes qendrore që gjendet në podrumin e ndërtesës së Agjencisë, ndërrimin e siguresave të rrymës, izolimin e hapësirave të jashtme të objektit. Po ashtu, në këtë projekt është i përfshirë edhe renovimi i ndërtesës së ANK – Pejë, i cili edhe është përfunduar dhe i ndërtesës ku është i vendosur dhe operon përkohësisht Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit.



*Fig.1. Ndërtesa e Agjencisë para punimeve*



*Fig.2. Ndërtesa e Agjencisë pas punimeve*

Investime kapitale u realizuan edhe në Depon e Agjencisë (Arkivin qendror), aty ku ruhen dokumentet arkivore, ku vlen të theksohet se tenderi për klimatizim dhe antizjarr për depon ishte iniciuar nga MKRS-ja në nëntor të vitit 2019, ndërsa punimet filluan në tetor të vitit 2020. Për të realizuar këtë, në vitin 2019 ishin ndarë dhe aprovuar me Ligjin për buxhetin vjetor të shtetit, me Nr. 07/L-001 mjete buxhetore prej 400,000.00€, por pastaj në nën kodin e AShAK-së ishin alokuar vetëm 233,000.00€, për shkak të nevojës së reduktimit të shpenzimeve për shkaqe të pandemisë Covid-19, ku edhe prej tyre MKRS-ja, i ka tërhequr më vonë 126,666.67€.

Shpenzime për investime në Depon e AShAK, për këtë periudhë janë bërë vetëm 51,735.78€.

## 5. RREGULLIMI, PËRPUNIMI, MBROJTJA DHE DIGJITALIZIMI I LËNDËS ARKIVORE

Në depot e Agjencisë, ruhen rreth 8 km gjatësi lineare e lëndës arkivore, ndërsa njëri ndër prioritetet e punës së Agjencisë është rregullimi, përpunimi, mbrojtja dhe digjitalizimi i lëndës arkivore.

Punët dhe detyrat e Agjencisë janë të ndara sipas klasifikimit të vendeve të punës dhe normave të punës.

### 5.1 Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore

Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Depos në Agjenci ka furnizuar Divizionin e Rregullimit, Divizionin e Mbrojtjes dhe Njësinë e Digjitalizimit me material për punë operative. Po ashtu, janë sistemuar e renditur nëpër raftet në Depo 36 m.gj. të gazetave të ndryshme, 42 m.gj. dokumente të fondit Habitat, si dhe është bërë ndërrimi dhe sistemimi i rafteve.

Janë rregulluar dhe përpunuar 114.84 m.gjatësi lineare e lëndës arkivore dhe janë klasifikuar 86.93 m.gjatësi lineare e lëndës arkivore, ndarë sipas njësive në vijim:

Departamenti i Veprimtarisë Arkivore - Divizioni i Rregullimit - Janë rregulluar dhe përpunuar 31.87 m.gj., e lëndës arkivore në këto fonde:

- Fondi *Gjykata Ekonomike e Qarkut* Gjakovë .....17.05m.gj.
- Fondi *Spitali i Përgjithshëm*, Njësia Organizative Neuropsikiatri.....13.69m.gj.
- Fondi *Prokuroria Publike e Prishtinës*.....1.13m.gj.

**Arkivi Ndërkomunal i Prishtinës** - Janë rregulluar dhe përpunuar **10.77** m. gj., e lëndës arkivore, të fondit *Gjykata Komunale* – Prishtinë.

**Arkivi Ndërkomunal – Gjakovë** - Janë rregulluar dhe përpunuar **4.90** m. gj., e lëndës arkivore në fondet:

- *Drejtoria për Urbanizëm*, .....3.80m.gj.
- *Banka Themelore (Bankos) Gjakovë*, .....1.10 m.gj.

**Arkivi Ndërkomunal – Mitrovicë** - Janë rregulluar dhe përpunuar **12.73** m.gj., e lëndës arkivore në fondet:

- *Gjykata e Qarkut*- Mitrovicë;
- *Kuvendi Komunal - Libra*.

**Arkivi Ndërkomunal– Prizren** - Janë rregulluar dhe përpunuar **23.92** m. gj. e lëndës arkivore dhe janë klasifikuar **60,43** m.gj., e lëndës arkivore në këto fonde:

- *Kuvendi Komunal i Suharekës*;
- *Kuvendi Komunal i Rahovec*;
- *Sindikatat – Prizren*;

- Partitë Politike – *Partia socialiste serbe*;
- *Kuvendi Komunal Prizren – Libra*,
- Ndërmarrja publike dhe komunale e ujësjellësit *Cvilen*;
- Ndërmarrja publike *Famipa – Prizren (1953-1963)*;
- Ndërmarrja publike *Slloga – Granit Prizren (1945-1956)*.

**Arkivi Ndërkomunal – Gjilan** - Janë rregulluar dhe përpunuar **21.55** m. gj. e lëndës arkivore dhe janë klasifikuar **26.50** m.gj. e lëndës arkivore në fondin *Spitali Regional i Gjilanit*.

**Arkivi Ndërkomunal – Pejë** - Janë rregulluar dhe përpunuar **9.10** m. gj., e lëndës arkivore në fondin- *Gjykata e Qarkut Pejë*.

### 5.2 *Mbrojtja e lëndës arkivore*

Agjencia, gjatë vitit ka konservuar 4.449 fletë A4, prej tyre janë restauruar 2.374 fletë A4, si dhe është bërë lidhja e 44 Regjistrave/librave me lidhje të fortë dhe 12 Regjistra/libra me lidhje të butë.

### 5.3 *Digjitalizimi i lëndës arkivore*

Është bërë digjitalizimi i **68,544** dokumenteve të fondit - *Gjykata e Qarkut Prizren*, të cilat janë futur në Sistemin për Menaxhimin e Shënimeve dhe Dokumenteve dhe janë të qasshme për të gjithë të interesuarit.

Janë digjitalizuar **9** mikrofilma: Sig II / 1-1 deri 1-6, ku janë digjitalizuar **5390** mikrokuadra. Po ashtu, është bërë përkthimi dhe digjitalizimi i Librit të inventarit të mikrofilmave të sjella nga Arkivat e Jugosllavisë.

Janë digjitalizuar **281** eksponate të Ekspozitave të ndryshme të organizuara nga AShAK-ja, si dhe është bërë vendosjen e tyre në Sistemin për Menaxhimin dhe Përshkrimin e Fondeve dhe Koleksioneve arkivore (nga Ekspozitat: *Gjergj Kastrioti Skënderbeu; Dëbimi i shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit; Arsimi shqiptar nëpër dokumente arkivore; 40 vjetori i demonstratave të vitit 1968; 100 vjetori i lidhjes shqiptare të Prizrenit; Figurat kombëtare shqiptare dhe familjet aristokrate në veprat e artistëve evropian; Qytetet shqiptare në fotografi të vjetra 1863-1916: Kosova në arkivin e shtetit shqiptar*).

Është bërë mirëmbajtja e vazhdueshme e Data Serverit të AShAK-së dhe në të janë migruar **68,544** skanime elektronike, si dhe është bërë vendosja e përshkrimit të **982** dosjeve në Sistemin për Menaxhimin e Shënimeve dhe Dokumenteve.

Është bërë inventarizimi i **306** audio shiritave magnetik (Mbledhje të Kryesisë së Kuvendit Krahinor të Kosovës), të viteve 1973 – 1990.

Në Arkivin Ndërkomunal të Gjakovës, është bërë digjitalizimi i fondit *Drejtoria e Urbanizmit - Gjakovë*, vitet 1995-1996, në sasi prej **7,018** dokumenteve.

Gjatë kësaj periudhe janë incizuar dhe ruajtur 5 seanca gjyqësore të Dhomave të Specializuara në Hagë, sipas vendimit të Kryshefi Ekzekutiv i Agjencisë.

## 6. SHËRBIMI I QYTETARËVE ME DOKUMENTE ARKIVORE

Agjencia, përveç ruajtjes, mbrojtjes dhe digjitalizimit të lëndës arkivore, rëndësi të veçantë i kushton edhe dhënies së saj në shfrytëzim, për nevojat e ndryshme të qytetarëve.

Gjatë vitit Agjencia ka pranuar **1539** kërkesa për dokumente të ndryshme, si për nevoja publike, private, shkencore e të tjera.

Në vazhdim paraqiten të dhënat për shërbimin e qytetarëve, sipas njësive të Agjencisë:

|                                      |                    |
|--------------------------------------|--------------------|
| Departamenti për Veprimtari Arkivore | <b>421</b> kërkesa |
| Arkivi Ndërkomunal Prishtinë         | <b>471</b> kërkesa |
| Arkivi Ndërkomunal Gjakovë           | <b>94</b> kërkesa  |
| Arkivi Ndërkomunal Mitrovicë         | <b>213</b> kërkesa |
| Arkivi Ndërkomunal Prizren           | <b>17</b> kërkesa  |
| Arkivi Ndërkomunal Gjilan            | <b>154</b> kërkesa |
| Arkivi Ndërkomunal Pejë              | <b>169</b> kërkesa |

Në Sallën e hulumtuesve në Agjenci, janë shërbyer **224** kuti arkivore, **99** fashikuj, **163** gazeta „Rilindja” dhe **54** Gazeta Zyrtare e Kosovës, për hulumtues të cilët e frekuentuan këtë sallë gjatë vitit.

## 7. BIBLIOTEKA E ARKIVIT

Përveç ruajtjes dhe menaxhimit të dokumenteve arkivore, Agjencia ka edhe Bibliotekën e Arkivit, e cila ruan dhe menaxhon me shumë tituj bibliotekar, ku një pjesë e tyre mund të konsiderohen si tituj të veçantë.

Për të mirëmbajtur, menaxhuar dhe për të dhënë në shfrytëzim titujt bibliotekar, gjatë vitit në Bibliotekë u bë skanimi e **1548** kopertinave të librave, si dhe u bë katalogimi i **1768** titujve në skedarin digjital.

Gjatë kësaj periudhe Biblioteka u pasurua me **14** tituj (27 ekzemplar) të ri nga autor të ndryshëm, të cilët vullnetarisht i dorëzuan bibliotekës botimet e tyre.

Po ashtu, biblioteka ka shërbyer 12 palë me tituj të ndryshëm, sipas kërkesave.



## 8. PRANIMI I LËNDËS ARKIVORE DHE INSPEKTIMI TE FONDKRIJUESIT

Për të pasuruar fondet arkivore, Agjencia gjatë vitit pranon fonde të ndryshme nga Institucionet qendrore e lokale, nga persona fizikë e juridikë, sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2020, në Agjenci janë pranuar:

- Dokumentet e fondit 3% - Austri, (hapja dhe mbyllja e fondit 3% si faturat, fletë-evidencat në sasi prej 30.285 fatura, 69 fletë evidenca), të dorëzuara nga personi fizik Bajrush Azemi;
- 4 dosje me 722 faqe - Aktakuza dhe Aktgjykime ndaj ish punëtorëve të Sekretariatit Krahinor për Punë të Brendshme (SKPB), të dorëzuara nga personi fizik Sheremet Krasniqi;
- Janë pranuar gazetatat ditore „Rilindja” vitet 1999-2008, në sasi prej **16.4** m.gj. lineare.

Janë bërë vizita e inspektime nëpër institucione të ndryshme qendrore e lokale, për të parë gjendjen e ruajtjes dhe menaxhimit të lëndës arkivore. Vizitat dhe inspektimet e bërja me këtë rast janë: 111 fondkrijues (Divizioni i Inspektimit Prishtinë – 25 vizita, ANK –Pejë - 12 vizita; ANK-Gjilan – 26 vizita; ANK- Prizren 9 vizita , ANK-Mitrovicë – 19 vizita dhe ANK-Gjakovë 20 vizita), të cilët janë këshilluar e rekomanduar sipas nevojës për përmirësime profesionale në punë.

## 9. ZHVILLIMI I POLITIKAVE NË ASHAK

Në fushën e hartimit të politikave zhvillimore, gjatë vitit në Agjenci janë bërë propozime për përmirësimin e cilësisë së punës dhe propozime për Plan të punës për vitin 2021. Gjithashtu janë përgatitur raporte periodike e vjetore të punës për MKRS dhe Agjencinë, si dhe janë bërë analiza të raporteve të punës pas çdo tremujori/vjetori, duke nxjerr me përqindje realizimin e Planit të punës, si dhe duke dhënë rekomandime konkrete për realizim të Planit.

Po ashtu, është përgatitur Plani i punës 2021-2023 në ASHAK, për përfshirje në Planin e Qeverisë, si dhe Plani i punës vjetore 2021 për Agjencinë. Janë përgatitur edhe plan-programet për Trajnim me zyrtarët e ASHAK për *Përdorimin e sistemit për e-pasuri* dhe *Përdorimin e e-mailit zyrtar dhe rifreskimin e saj*, i cili u realizua në fillim të vitit 2020.

Është realizuar trajnimi me zyrtarët e ASHAK me temë: *Përdorimi i sistemit për e-pasuri* dhe *Përdorimi i e-mailit zyrtar dhe rifreskimin e saj*. Trajnimi u mbajt në tetë (8) grupe, në Objektin e ASHAK me datë 18-19.2.2020, tri grupe, ndërsa nga data 20 - 26.2.2020 në Objektet e ANK-ve, pesë grupe, sipas Planit të trajnimit.

## 10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR ARKIVOR

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, si institucioni më i lartë në Kosovës në fushën e arkivistikës, është edhe anëtare me të drejta të barabarta në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave Ndërkombëtare (ICA). Gjithashtu, Agjencia ka edhe Marrëveshje Bashkëpunimi me Arkivat e shteteve të ndryshme dhe me Institucionet tjera të po kësaj fushe.

Gjendja pandemike me COVID – 19, ka ndikuar në mosrealizimin e shumë aktiviteteve të cilat ishin planifikuar të realizohen brenda vitit, edhe pse është përgatit Drafti për ripërtëritjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Agjencinë e Arkivave Shtetërore të Bullgarisë. Kjo Marrëveshje ende nuk është nënshkruar për shkak të kufizimeve të lëvizjes.

Zhvillimi i bashkëpunimit vazhdoi me Institucione vendore, ku gjatë vitit Agjencia nënshkroi Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin AAB.

Në kuadër të bashkëpunimit Ndërkombëtar e Ndërinstitucional u realizuan vizita dhe aktivitete si:

- Më 10.1.2020, Agjencinë e vizitoi drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, z. Ardit Bido me bashkëpunëtorët e tij. Vizita kishte për qëllim intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.
- Më 31.1.2020, delegacioni i Agjencisë i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Bedri Zyberaj me bashkëpunëtorët e tij realizuan vizitë zyrtare në DPA të Shqipërisë. Qëllimi i vizitës ishte organizimi i ekspozitës „Kosova në Arkivin e Shtetit Shqiptar“.
- Më 11.2.2020, AShAK-në e vizitoi drejtori i Arkivit Shtetëror të Maqedonisë, z. Emil Krsteski me bashkëpunëtorët e tij. Vizita kishte për qëllim intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.
- Më 11.7. 2020, në Sarandë - Shqipëri, u mbajt Konferenca e IV Mbarëkombëtare, bashkë organizim i AShAK dhe DPA-në.
- Më 23.11. 2020, në ambientet e AShAK-së në Prishtinë, u hap Këndi arkivor i DPA-së. Qëllimi i hapjes së këndit arkivor është që të nxitë hulumtimin e qytetarëve në arkiva dhe t’ua lehtësojë punën studiuesve që të hulumtojnë dokumentet arkivore, të cilat gjenden në arkivin e shtetit shqiptar. Ky shërbim do të ofrohet me të njëjtat rregulla, procedura dhe me të njëjtën formë dhe shpejtësi sikurse në Sallën e studimit të DPA-së, në tiranë.

## 11. PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE ARKIVORE

Agjencia, përveç rregullimit, mbrojtjes, digjitalizimit dhe dhënies në shfrytëzim të lëndës arkivore, rëndësi të veçantë i kushton edhe publikimit të dokumenteve arkivore.

Për këtë qëllim, më 17.2.2020, për nder të 12 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në bashkëpunim me DPA-në e Shqipërisë hapi Ekspozitën „Kosova në Arkivin e Shtetit Shqiptar“.

Pas kësaj date, dihet se edhe në vendin tonë filloi infektimi me virusin COVID-19, gjë që edhe institucionit tonë ia vështirësoi punën dhe ia kufizoi mundësinë për realizimin e planit të punës për vitin 2020.

Megjithatë, edhe pse në kushte të vështira, për shkak të gjendjes pandemike, Agjencia gjithnjë duke respektuar vendimet e Qeverisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së për mbrojtje ndaj COVID - 19, arriti të realizojë disa aktivitete. Njëri prej tyre është ai i dt. 24.11.2020, kur për nder të 28 Nëntorit, hapi Ekspozitën „Nga nëntorët vijmë në nëntorë shkojmë”. Edhe kjo Ekspozitë ishte bashkorganizim i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë. Për të dy ekspozitat u botuan katalogë. Po ashtu, më 25.9.2020, me rastin e hapjes së edicionit të parë të Panairit të Librit të Vjetër, të Rrallë dhe të Përdorur nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, në oborr të Institutit Agjencia rihapi një fragment të Ekspozitës „Kosova në Arkivin e Shtetit Shqiptar”.

U botua Revista „Arkivat shqiptare”, botim i përbashkët i Agjencisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.

## 12. BUXHETI DHE FINANCAT

Në fillim të vitit 2020, Agjencia ka pasur një buxhet të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në vlerë 1,244,166.79€, por për shkak të përhapjes së pandemisë, Qeveria kishte vendosur që të bëjë shkurtime buxhetore për të gjitha institucionet shtetërore, ku edhe Agjencia si institucion Shtetëror i Republikës së Kosovës u dëmtua në këtë aspekt. Nga buxheti fillestar në vlerë 1,244,166.79€, Agjencisë iu tërhoqën 199,518.06€, ndërsa iu shtuan buxhet te pagat dhe mëditjet në vlerës 2,647.29€, ku për mbulimin e shpenzimeve buxhetore Agjencisë i mbeten për shfrytëzim 1,048,788.84€

Të dhënat buxhetore në AShAK, të ndara në kategori janë:

| Nr. | Kategoritë Ekonomike | Buxheti fillestar   | Shkurtime buxhetore | Shtimet buxhetore | Buxheti përfundimtar | Shpenzimet buxhetore | Shpenzimet në përqindje |
|-----|----------------------|---------------------|---------------------|-------------------|----------------------|----------------------|-------------------------|
| 1   | Paga/Mëditje         | 641,062.79          |                     | 2,647.29          | 643,710.08           | 643,710.08           | 100%                    |
| 2   | Mallra/Shërbimet     | 144,429.00          | 20,000.00           |                   | 124,429.00           | 124,317.29           | 99.91%                  |
| 3   | Komunale             | 27,585.00           | 12,851.39           |                   | 14,733.61            | 13,737.29            | 93.23%                  |
| 4   | Të hyrat vetanake 22 |                     |                     |                   | 1,492.82             | 1,492.82             | 100%                    |
| 5   | Të hyrat vetanake 21 | 31,090.00           |                     |                   | 31,090.00            | 10,278.72            | 33.06%                  |
| 6   | Investime kapitale   | 400,000.00          | 166,666.67          |                   | 233,333.33           | 118,402.45           | 50.74%                  |
| 7   | <b>TOTAL</b>         | <b>1,244,166.79</b> | <b>199,518.06</b>   | <b>2,647.29</b>   | <b>1,048,788.84</b>  | <b>911,938.59</b>    | <b>86.95%</b>           |

Agjencia, gjatë veprimtarisë së saj realizon edhe të hyra vetanake nga shërbimi me lëndë arkivore për palët dhe nga qiradhënia e hapësirave të saj, ku për këtë vit të hyra vetanake ishin:

| Nr. | Të hyrat nga palët             | Janar        | Shkurt       | Mars         | Prill        | Maj           | Qershor       | Korrik     | Gusht        | Shtator      | Tetor        | Nëntor       | Dhjetor      | Total          |
|-----|--------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|---------------|------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|----------------|
| 1   | ASHAK-DVA                      | 159.4        | 156.4        | 76.7         |              | 68.00         | 90.9          | 37.5       | 34.4         | 172.7        | 80.9         | 57.4         | 201.8        | 1,136.1        |
| 2   | ANK-Prishtinë                  | 131.00       | 332.2        | 165.4        |              |               | 249.00        | 240.7      | 291.2        | 85.2         | 257.2        | 171.7        | 182.7        | 2,106.3        |
| 3   | ANK-Prizren                    | 58.8         |              | 28.4         |              |               |               | 12.6       |              |              | 13.8         | 5.5          |              | 119.1          |
| 4   | ANK-Pejë                       | 80.5         | 93.00        |              |              | 71.00         | 68.00         | 97.2       |              |              | 81.5         | 73.5         | 67.00        | 631.2          |
| 5   | ANK-Gjakovë                    |              | 67.00        | 28.00        | 16.00        |               | 546.00        | 37.00      | 13.00        | 5.00         | 39.00        | 30.0         | 32.00        | 813            |
| 6   | ANK - Mitrovicë                | 22.00        | 87.9         | 44.00        |              |               | 51.5          |            | 57.5         | 38.00        | 105.00       | 47.2         | 32.9         | 486            |
| 7   | ANK - Gjilan                   | 44.00        | 63.00        | 62.00        |              |               | 25.5          | 35.00      | 46.00        | 28.00        | 52.00        | 53.5         | 20.00        | 429            |
|     | <b>Totali</b>                  | <b>495.7</b> | <b>799.5</b> | <b>404.5</b> | <b>16.00</b> | <b>139.00</b> | <b>1030.9</b> | <b>460</b> | <b>442.6</b> | <b>328.9</b> | <b>629.4</b> | <b>438.8</b> | <b>536.4</b> | <b>5,721.2</b> |
|     | <b>Të hyrat nga qiradhënia</b> |              |              |              |              |               |               |            |              |              |              |              |              |                |
| 8   | Qiraja e RTK-së                | 1,000.00     |              |              |              |               |               |            |              |              | 5,000        | 2,500.00     |              | 8,500.00       |
|     | <b>Gjithsejtë .....</b>        |              |              |              |              |               |               |            |              |              |              |              |              | <b>14221</b>   |

### 13. PROKURIMI

Në fillim të vitit 2020, Agjencia ka dorëzuar raportin e kontratave të nënshkruara të vitit 2019 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës (KRPPK). Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, duke paraqitur të gjitha aktivitetet e prokurimeve publike të realizuara në Agjenci, sipas kontratave të nënshkruara.

Pas miratimit të buxhetit, për vitin fiskal 2020, Agjencia ka përgatitur dhe ka dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njësive kërkuese (departamentet) të aprovuara nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE).

Duke u bazuar në Planin e Prokurimit, në Agjenci, gjatë vitit, janë realizuar 20 procedura të prokurimit.

Në vazhdim paraqesim aktivitetet e prokurimit publik të realizuara gjatë vitit 2020 në Agjenci:

| Nr. | Përshkrimi i kontratës – Mallra dhe shërbime   |
|-----|--|
| 1.  | Printimi i ekspozitës “Kosova në Arkivin e Shtetit Shqiptar”                                     |
| 2.  | Ngjyrosja (lyerja) e hapësirave të brendshme të AShAK-së   |
| 3.  | Furnizim me kuti arkivore  |
| 4.  | Furnizim me tepihë   |
| 5.  | Furnizim me lule   |
| 6.  | Veshja e tri dyerve me skaj për AShAK-në   |
| 7.  | Shërbime dhe furnizime pastrimi për Arkivat Ndërkomunale në Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë |
| 8.  | Vijëzimi i parkingut të ASHAK-së   |
| 9.  | Furnizim me mjete mbrojtëse në punë  |
| 10. | Furnizim me dezinfektues antibakterial   |
| 11. | Furnizim me pajisje të IT  |
| 12. | Furnizim me vula për ASHAK-në  |
| 13. | Renovim i Labororit për mbrojtjen e dokumenteve arkivore   |
| 14. | Servisimi, kontrollimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit për Arkivat Ndërkomunale           |
| 15. | Furnizim me material restaurues  |
| 16. | Furnizim me mbështjellës të lëndëve arkivore   |
| 17. | Furnizim me termometra për nevojat e ASHAK-së  |
| 18. | Furnizim me maska dhe dezinfektues   |
| 19. | Printimi i ekspozitës dhe printimi i tabelave për këndin Arkivor                                 |
| 20. | Shërbime të sigurimit të automjeteve të AShAK-së   |

Për të gjitha aktivitetet e realizuara, janë shkarkuar nga sistemi informativ i menaxhimit të financave publike të Kosovës (SMFPPK), urdhër blerjet për shpenzimet me prokurim për kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomik.

Po ashtu, në fund të vitit është bërë Planifikimin i Prokurimit Publik për vitin 2021 në AShAK, i cili është dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik të Kosovës.

#### 14. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, gjatë vitit ka kryer aktivitete të shumta në fushën e saj, siç është përgatitja e Planit i Personelit për vitin 2020, Raporti Statistikor, Plani i Trajnimeve, si dhe të dhënat etike për korrupsion, për mbarë stafin e ASHAK-së, të cilat janë përcjellë në mënyrë fizike dhe elektronike SIMBNJ, në Departamentin e Administratës për Shërbimin Civil /MAP.

Është bërë menaxhimi i sistemit të vijueshmërisë në punës, ku janë kontrolluar dhe nxjerrë raporte mbi vijueshmërinë e zyrtarëve të ASHAK-së.

Është bërë mbajtja dhe përgatitja e Procesverbaleve të Mbledhjeve të Kolegjiumit në ASHAK.

Gjatë vitit në Agjenci është mbajtur një seancë e ankesave, ku janë bërë përgatitjet e nevojshme për realizimin e saj. Janë përgatitë dokumentet për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe janë përcjellë të gjitha procedurat deri në përfundim të saj.

Sipas Kërkesës së Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA,) janë përgatitë dhe dorëzuar regjistri i gjithë zyrtarëve të rekrutuar, pushimet e lindjes, pensionimet dhe marrëveshjet e veçanta të shërbimit për vitin 2019.

Janë përgatit dhe dorëzuar formularët për numrin e zyrtarëve në detyrë dhe atyre që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, si dhe janë përgatit listat për deklarim të pasurisë për zyrtarët menaxherial në ASHAK.

Është bërë përgatitja dhe dorëzimi i ndryshimeve në Sistemin e Pagesave.

Janë përgatitë 36 Vendime të nxjerra nga Kryeshefi Ekzekutiv; dy (2) autorizime sipas kërkesës së dy drejtorëve të departamenteve; tri (3) Letër Rekomandime për dy praktikant që kanë kryer praktikën në ASHAK, janë evidentuar 87 kërkesa të natyrave të ndryshme të pushimeve dhe 5 formularë për vlerësim në punë.

Janë protokolluar 218 shkresa hyrëse dhe dalëse, të natyrave të ndryshme.